



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS - SHTIME
Komiteti për Politikë dhe financa
Nr.01-060/01-12831/23 datë: 23.05.2023



Npi – 01/217 datë: 29.05.2023

Duke u bazuar në nenin 49 dhe 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040; Si dhe në bazë të nenit 3.13 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve, Npi-01/114 të datës: 26.04.2019, Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më: 29.05.2023 nxjerr këtë:

E K S T R A K T
PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË -V- TË KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

E mbajtur më datën: 29.05.2023 (e hënë) në ora 09:00 h. në sallën e vogël të Kuvendit

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesi i KPF-së z.Adnan Ademi, Anëtarët e Komitetit: z.Përparim Ramusa, z.Lumni Amrushi, znj.Adelina Beqaj, znj.Saniye Sadiki, dhe z.Kadri Emini. Përveç anëtarëve të KPF-së në mbledhje ka marrë pjesë edhe: z.Grejtalb Emini drejtori i DPUKG-së, z.Bardhyl Rushiti drejtor i DSHP-së, z.Bujar Ferati zyrtar kryesor financiar, znj Kimete Uka, zyrtare financiare dhe z.Reshat Gashi, zyrtar për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore. Mbledhjen e hapi, Kryesuesi i KPF-së z.Adnan Ademi, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

REND DITE

1. Bartja e buxhetit të pa shpenzuar nga viti i kaluar në vitin aktual, dhe rritja e kufirit të hyrave,
2. Draft-Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale 2024-2026,
3. Propozim-Vendim për ndryshimin e vendimit të Kuvendit Npi-01/76 Për plotësimin e KPF me anëtarë të ri,
4. Propozim-Vendim për zgjedhjen e dy anëtarëve të Komisionit për ndarjen e bursave për studentë, 2023/2024,
5. Propozim për ndryshimin e nenit 3 të Rregullores për ndarjen e bursave për studentë Npi-01/60 dt.30.03.2012,
6. Propozim-Vendim për miratimin e iniciativës ndërkomunale për menaxhimin e integruar të mbeturinave,
7. Draft-Programi tre vjeçar për banim social në komunën e Shtimes 2023-2025,
8. Propozim-vendim për ndryshimin e destinimit të pronës së paluajtshme komunale në N.K. numër P-003020-2 ZK-Shtime,
9. Propozim-Vendim për hapje të rrugës publike në Z.K – Karaqicë.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për rendin e ditës.

z.Përparim Ramusa; Përshëndetje, pajtohem me rendin e ditës përveç te pika e 3 që propozoj që këtë pikë me hjekë dhe me qu drejtë në Kuvend.

z.Kadri Emini; Përshëndetje, unë nuk po e shoh të arsyeshme me shty pikën 3. E kemi një vendim të MAPL-së, mundemi me i rekomandu Kuvendit që të kryhet plotësimi i KPF-së dhe me përfundu si proces.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Pajtohem me propozimin e Kadriut.

***Komiteti për Politikë dhe Financa, me 3 vota "Për", me 2 vota "Kundër" dhe me 1 votë "Abstenim" miratoj rendin e ditës siç është propozuar.**

Pika 1

Bartja e buxhetit të pa shpenzuar nga viti i kaluar në vitin aktual, dhe rritja e kufirit të hyrave

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Fjalën ja dha z.Bujar Feratit.

z.Bujar Ferati, ZKF; Përshëndetje, kemi mbajtur takime me përfaqësuesit e grupeve parlamentare dhe propozimet që janë bërë i kemi marrë në formë të shkruar (shih dokumentin), nëse ka pyetje do të përgjigjem.

znj.Adelina Beqaj; Me kënd keni mbajtur takime?

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Në takim kanë marrë pjesë Rexha, Reshati edhe Bujari, te mallrat dhe shërbimet janë bërë ndryshimet siç ka thënë Përparimi. Ndryshimet janë bërë siç ka kërkuar opozita. Unë jam i pajtimit për me i rekomandu Kuvendit për aprovim.

z.Përparim Ramusa; Dakordimi që e kemi bërë nuk ka shkuar deri në fund. Ne kemi kërkuar 40.000 euro subvencione me shku në Sport. Ne si opozitë po kërkojmë me i shpërnda te Klubet Sportive. Te shpronësimet, është njëfar rendi që shpronësimet të bëhen ashtu që të paguhen ata që u janë marrë më herët. Nëse këto përmirësohen ne jemi "pro" nëse jo atëherë ne jemi "kundër".

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Në parim pajtohem me ty. Në rregull është me i pagu ato të mëhershmet.

z.Bujar Ferati, ZKF; Te shpenzimet dhe te subvencionet e Kulturës. Te subvencionet e Kulturës është bërë një njoftim për dy herë dhe është në kundërshtim me Rregulloren nuk ka siguri që Klubeve me ju dhanë 2 herë. Te shpenzimet ne e kemi ditë që kemi borgj. Kemi kërkuar një kod buxhetor. Te shpenzimet e mëparshme nëse janë në fund të procedurës, Ekzekutivi duhet me i sjellë për pagesë. Ne kemi me i ekzekutua ato lëndë që janë të përfunduara. Ka vërejtje që nuk janë ekzekutuar më herët. Ne e kemi obligim me i ekzekutu.

z.Grejtalb Emmini, DPUKGJ; Përshëndetje, unë dua të jap përgjigje, teni është vetëm një lëndë duke pritur ekzekutimin në vlerë prej rreth 5900 euro. Te vendimi i shpronësimit për 33 pronat, ka shkelje ligjore e kam emailin që ma ka kthyer Ministria e Financave, ku e ka konfirmuar se nuk është planifikuar buxheti në vitin 2021.

znj.Kimete Uka; Përshëndetje, do të japë një sqarim për sa i përket shpronësimeve. Nuk kemi ndonjë lëndë të përfunduar që po pret për pagesë.

z.Bujar Ferati, ZKF; Projektet Kapitale kanë ardhur duke u ndryshuar, nuk ka më Projekte Kapitale duke i ç'vendosur mjetet nga mallra dhe shjërbyme në projekte kapiotale sepse nuk lejohen me u pagu.

znj.Adelina Beqaj; Unë nuk mundem me u pajtuar kështu, diçka tjetër merremi vesh e diçka tjetër na vjen këtu. Nuk mund të pajtohem me politikat ditore të juaja.

z.Bujar Ferati, ZKF; Pra për me dalë nga situata po i marrim 40.000€ nga shpenzimet, për me i qu te kultura, e me i bërë aty 45.000€. E te shpenzimet me mbetë 39.000€.

z.Përparim Ramusa; Nëse kan mbërri që mjetet me shku te renovimi i pullazit të Shtepisë së Kulturës dhe 40.000€ me shku për kulturë unë e jap votën.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Atëherë pra te kolona e 8 kemi ndryshim nga 79.500 euro mbesin 39.500 euro kështu që 40.000€ shkojnë te kultura për subvencione në sport.

***Komiteti për Politikë dhe Financa, me 5 vota "Për" me 0 vota "Kundër" dhe me 1 votë "Abstenim" vendosi që t'i rekomandoi Kuvendit miratimin e Bartjes së buxhetit të pa shpenzuar nga viti i kaluar në vitin aktual, dhe rritja e kufirit të hyrave, me ndryshimin që te kolona e 8 nga 79.500 € të merren 40.000€ dhe të dërgohen te kultura për Subvencione në Sport.**

Pika 2

Draft-Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale 2024-2026

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha z.Bujar Feratit.

z.Bujar Ferati, ZKF; Nuk do ta zgjasë shumë, vetëm ju lusë që ta votoni Draft - Kornizën Afatmesme Buxhetore Komunale 2024-2026, kështu si është prezantuar, sepse kjo do të shkojë në diskutim publik, dheb ka me ardhur edhe një herë këtu dhe kemi me ndryshu aty ku na lejohet.

***Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht vendosi t'i Rekomandoi Kuvendit, miratimin e vendimit për ta nxjerrë në diskutim publik për 15 ditë, Kornizën Afatmesme Buxhetore 2024-2026.**

Pika 3

Propozim-Vendim për ndryshimin e vendimit të Kuvendit Npi-01/76 Për plotësimin e KPF-së me anëtarë të ri

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; E kemi marrë një konfirmim nga MAPL-ja që është në kundërshtim me ligjin dhe janë dhënë sqarime se anëtari i KPF-së duhet të jetë nga i njeiti subjekt politik dhe nga e njejta gjini. Kemi diskutuar shumë për këtë temë por ligji nuk po e lejon një vendim të tillë për të cilin unë pata reaguar që në fillim kur u aprovua. Unë pra e kam thënë dhe e kam përsëritur disa herë në mbledhje të Kuvendit se nuk lejohet shkelja e ligjit për ta marrë një vendim të tillë.

z.Kadri Emini; Sa i përket zëvendësimit të anëtarëve të Komiteteve, atëherë kam thënë se secili grup parlamentar e zgjedhë vetë anëtarin që do ta zëvendësojë dhe në këtë rast duhet me ardhë Zejnija, sepse e ka propozuar Vetëvendosja, dhe nuk kemi alternativë tjetër.

z.Përparim Ramusa; Ne si PDK-ë e kemi përmbushur obligim tonë me kandidatë.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Unë propozoj që kjo pikë me kaluar për Kuvend për miratimin e sajë.

***Komiteti për Politikë dhe Financa, me 4 vota "Për", me 3 vota "Kundër" dhe me 0 vota "Abstenim"** (duke përdorur të drejtën e votës së dyfishtë të Kryesuesit) vendosi t'i Rekomandoi Kuvendit, miratimin e Vendimit për ndryshimin e vendimit të Kuvendit, Npi-01/76, për plotësimin e KPF me anëtarë të ri, ashtu qysh e ka dhënë rekomandimin MAPL-ja, që anëtari i ri i KPF-së që duhet ta zëvendësojë të vjetrin, duhet të vjen nga i njëjti subjekt politik dhe i gjinisë së njëjtë.

Pika 4

Propozim-Vendim për zgjedhjen e dy anëtarëve të Komisionit për ndarjen e bursave për studentë 2023/2024

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitet vendosi t'i Rekomandoi Kuvendit, miratimin e vendimit për zgjedhjen e dy anëtarëve të Komisionit për ndarjen e bursave për studentë, 2023/2024.**

Pika 5

Propozim për ndryshimin e nenit 3 të Rregullores për ndarjen e bursave për studentë Npi-01/60 dt.30.03.2012

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Rregulloren për bursa e kemi pak të vjetër, dhe e kanë propozuar DKA-ja një ndryshim në këtë rregullore i cili ka të bëjë me studentët që studiojnë jashtë Kosovës.

z.Idajet Rexhepi, Sekretar i Kuvendit; Përhëndetje, unë po prezantoj rekomandimet e KPK-së, nga mbledhja e mbajtur më 26.05.2023 lidhur me këtë pikë. Komiteti për Komunitete nuk e ka miratuar ndryshimin në nenit 3 të rregullores, por i rekomandon Kuvendit të Komunës së Shtimes, që me ndryshimin e Rregullores Komunale për ndarjen e Bursave për Student, të garantohen 5 (pesë) bursa për studentët e komunitetit pakicë.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Propozojë që me themelua një Komision për ndryshimin e rregullores për ndarjen e bursave për studentë.

z.Përparim Ramusa; Unë e përkrahu ndryshimin e nenit 3 të rregullores, por me pas mundësi për me rritë vlerën e bursës, atëherë unë e kisha votuar. Ndërsa rekomandimin e Komitetit për Komunitete e diskutojmë në Kuvend.

***Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitet vendosi t'i Rekomandoi Kuvendit, miratimin e vendimit për ndryshimin e nenit 3 të Rregullores për ndarjen e bursave për studentë Npi-01/60 të datës 30.03.2012 duke shtuar edhe fjalët (dhe studentët jashtë vendit).**

Pika 6

Propozim-Vendim për miratimin e iniciativës ndërkomunale për menaxhimin e integruar të mbeturinave

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha z.Bardhyl Rushiti.

z.Bardhyl Rushiti, DSHP; Ky është një plan në bashkëpunim me GIZ-in Gjerman, por është plan ndërkomunal për menaxhimin e mbeturinave, që përfshihen të gjitha komunat e ana-moravës. Nëse ka ndonjë pyetje unë do të mundohem të jap përgjigje, ju ftoj që t'i rekomandoni Kuvendit për miratim.

***Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitet vendosi t'i Rekomandoi Kuvendit, miratimin e iniciativës ndërkomunale për menaxhimin e integruar të mbeturinave.**

Pika 7

Draft-Programi tre vjeçar për banim social në komunën e Shtimes 2023-2025

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht vendosi t'i Rekomandoi Kuvendit, miratimin e vendimit për ta nxjerrë në diskutim publik për 15 ditë, Programin tre vjeçar për banim social në komunën e Shtimes 2023-2025.**

Pika 8

Propozim-vendim për ndryshimin e destinimit të pronës së paluajtshme komunale në N.K. numër P-003020-2 ZK-Shtime

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha z.Grejtalb Emini.

z.Grejtalb Emini, DPUKGJ; Ka pasë një ankesë që e kemi marrë parasysh, dhe po bëhet fjalë për rrugë "Mic Sokoli" unë me pres miratimin e kësaj pike. Po flitet shumë jashtë Komunës për këtë temë. **znj.Adelina Beqaj;** Pse po thuani se PDK-ja po i bllokoi projektet?

z.Kadri Emini; Çështja e opinioneve jashtë nuk na intereson. Mjafton që të jemi me ligj në rregull.

z.Përparim Ramusa; Kjo është një rrugë që ka ekzistuar prej që ekziston njerëzimi, nuk kemi për çka mos me e votuar, por pyetja është çështja e Tyrbes.

z.Grejtalb Emini, DPUKGJ; Te Tyrbja sot nëse du me shkuar, nuk ka rrugë, është e bllokuar. Mua më intereson që ajo rrugë me qenë e definuar.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Unë mendoj se duhet me u bë rruga publike, pjesë tjera u takojnë të tjerëve.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, me 3 vota "Për", me 0 vota "Kundër" dhe me 3 vota "Abstenim" vendosi t'i Rekomandoi Kuvendit, miratimin e vendimit për ndryshimin e destinimit të pronës së paluajtshme komunale në N.K. numër P-003020-2, ZK-Shtime, ashtu qysh e ka propozuar DPUKGJ-ja.**

Pika 9

Propozim-Vendim për hapje të rrugës publike në Z.K – Karaqicë

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha z.Grejtalb Emini.

z.Grejtalb Emini, DPUKGJ; E kemi një kërkesë nga një qytetarë nga Karaqica, z.Shefqet Krasniqi, ai ka kërkuar hapjen e rrugës në pronën komunale. Duke analizuar kërkesën dhe gjendjen në teren ne si drejtori i Rekomandojmë Kuvendit miratimin e këtijë propozim-vendimi.

***Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht vendosi t'i Rekomandoi Kuvendit, miratimin Vendimit për hapjen e rrugës publike në Z.K – Karaqicë, me vërejtjen që drejtori i DPUKGJ-së me i sjellë në mbledhjen e Kuvendit më 31.05.2023 edhe materialin shtesë për sqarimin e kërkesës të z.Shefqet Krasniqi nga fshati Karaqicë.**

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Pasi diskutime të tjera nuk kishte mbledhja përfundoi në ora 11:10h.

Procesmbajtësi
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i KPF
Adnan Ademi